

Vendim nr. 171 datë 19.07.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Illir Toska,	Anëtar
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 19.07.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 21 (A) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ABDYL HYSENI**, përfaqësuar nga avokat Florjan Gjoka, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 86-2016-830 (3686), datë 28.11.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-533, datë 18.01.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 41, 42, 43, 44, 131 dhe 181 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27 e vijues dhe 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*); nenet 148 dhe 444 të Kodit të Procedurës Civile, të ndryshuar; nenet 149, 153, 450, 608, 609 dhe 640 e vijues të Kodit Civil (*KC*); ligji nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”.**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Abdyl Hyseni (*kërkuesi*) ka qenë banor i fshatit Rranxë, ish-Komuna Cudhi, Krujë, ku ka pasur në pronësi 2 banesa (apartamente) dhe 5700 m² tokë bujqësore, të përfitur me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”.

2. Në vitin 1994, ndërsa është miratuar ndërtimi i ujëmbledhësit të Bovillës, me vendimin nr. 85, datë 02.01.1994 të Këshillit të Ministrave është vendosur që të gjitha familjet që përmblyten nga ky ujëmbledhës në rrethinën e Tiranës dhe të Krujës të shpërngulen në zonën e Bathores dhe të Babrrusë, duke u ngarkuar këshillat e rretheve Krujë dhe Tiranë që, brenda muajit mars të vitit 1994, të përcaktonin numrin e saktë të familjeve që shpërngulen dhe evidentuar numrin e frymëve, të banesave, sipërfaqes së banesës së truallit për çdo familje, si dhe zonën ku do të vendosen. Në këtë kuadër, ish-Komuna Cudhi, në datën 24.06.1994, ka hartuar listën me 31 familjet e shpërngulura në Tiranë. Me pretendimin se prekeshin nga ujëmbledhësi, ndërsa nuk janë përfshirë në këtë listë, kryefamiljarët e 11 familjeve, mes tyre edhe kërkuesi, kanë paraqitur padi, e cila është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë me vendimin nr. 301, datë 04.12.1997, duke detyruar të paditurin, Komunën Cudhi, të shtojë në listën e datës 24.06.1994 edhe 11 familjet e paditësve, si dhe t’ia dërgojë listën organit përkatës për t’i sistemuar me shtëpi dhe tokë në rreth tjetër.

3. Për një kërkesë të Komunës Cudhi, me urdhrin nr. 31/2001 të ministrit të Punëve Publike dhe Transportit është ngritur komisioni i posaçëm i shpronësimeve, i cili në vijim ka pranuar kërkesën për shpronësim për interes publik, duke përcaktuar pasuritë dhe vlerën e kompensimit për secilën nga 11 familjet si më lart. Për pasurinë e familjes së kërkuesit, kompensimi është përlllogaritur në vlerën totale prej 6 819 000 lekësh. Megjithatë, procedura e shpronësimit nuk ka vazhduar më tej sipas kërkesave të ligjit nr. 8561, datë 25.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, ndërsa nuk ka dalë vendim shpronësimi dhe kërkuesi nuk ka përfitur kompensim/shpërblim për pasuritë e marra në fakt pas ndërtimit të ujëmbledhësit. Për këtë arsye, ai, në mënyrë të vazhdueshme, i është drejtuar disa institucioneve shtetërore, por pa arritur zgjidhjen e këtij problemi.

4. Në datën 25.05.2015 kërkuesi ka paraqitur padi në gjykatë, duke kërkuar detyrimin e të paditurve, Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës (MTI) dhe Këshillin e Ministrave, për ta kompensuar financiarisht sipas vendimit nr. 1/2001 të komisionit të posaçëm të shpronësimeve, si dhe për t'i paguar kamatat ligjore për shkak të vonesës në përmbushjen e këtij detyrimi. Në përfundim të gjykimit, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 4137 (80-2015-2451), datë 21.07.2015, ka pranuar pjesërisht padinë e kërkuesit, duke detyruar palën e paditur t'i paguajë atij: (i) kompensimin për pronat e shpronësuara për ndërtimin e ujëmbledhësit të Bovillës, në vlerën 6 819 000 lekë; (ii) kamatat ligjore për vonesën në përmbushjen e këtij detyrimi, në vlerën 6 819 000 lekë. Nga ana tjetër, gjykata ka rrëzuar kërkimin në padi për pjesën tjetër të kamatave ligjore. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kërkuesi, i padituri MTI-ja, dhe Avokatura e Shtetit.

5. Gjykata Administrative e Apelit, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 86-2016-830 (3686), datë 28.11.2016, ka ndryshuar vendimin e gjykatës administrative të shkallës së parë, duke vendosur njëlloj si ajo në lidhje me detyrimin e palës së paditur për t'i paguar paditësit (kërkuesit) kompensim për pronat e shpronësuara në vlerën 6 819 000 lekë, ndërsa ka rrëzuar kërkimin e padisë për kamatat ligjore. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs kërkuesi, i padituri MTI-ja, dhe Avokatura e Shtetit.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2024-533, datë 18.01.2024, ka vendosur mospranimin e rekurseve të palëve, përfshirë edhe të rekursit të kërkuesit. Ai ka arsyetuar se shkaqet në rekurs nuk janë nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49, datë 30.05.2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*), sipas përmbajtjes së tij në kohën e paraqitjes së rekursit, të cilat e bënin të cenueshëm vendimin e Gjykatës së Administrative të Apelit.

7. Në datën 20.05.2024 (sipas shërbimit postar), kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 05.06.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

8.1. *E drejta për një proces të rregullt ligjor në drejtim të:*

- 8.1.1. *Së drejtës për t'u dëgjuar*, pasi gjykimi i çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është bërë dhomën e këshillimit pa praninë e palëve, duke vendosur ato përgjysmimin e vlerës së shpërblimit të fituar nga kërkuesi në gjykimin e çështjes në shkallë të parë.
- 8.1.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata Administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk kanë arsyetuar në vendimet e tyre se përse është rrëzuar kërkimi i padisë së kërkuesit për kamatat ligjore.
- 8.2. *E drejta e pronës private*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi vendimet gjyqësore të kundërshtuara, me të cilat është rrëzuar kërkimi i padisë për kamatat ligjore, i kanë cenuar kërkuesit të drejtën e pronës, pasi nuk kanë respektuar parimin kushtetues për shpërblimin e drejtë të saj.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kritere paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht dhe për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykit kushtetues.

10. Kolegji çmos se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

11. Një tjetër kriter paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Në të njëjtën linjë, neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, përcakton se mjetet juridike efektive duhet të shterohen nga kërkuesi përpara se ai t’i drejtohet Gjykatës.

12. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Kërkuesi, ndër të tjera, ka pretenduar cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar, duke qenë se gjykimi në Gjykatën Administrative të Apelit dhe ai në Gjykatën e Lartë, janë zhvilluar në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve. Për sa i takon këtij pretendimi në lidhje me gjykimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit, referuar akteve bashkëlidhur kërkesës, rezulton se një pretendim të tillë kërkuesi nuk e ka ngritur në rekursin e tij, duke mos shteruar kështu ai mjetet juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se pretendimi për cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar, për sa i takon gjykimin të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit, nuk mund të merret në shqyrtim.

14. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nga Gjykata Administrative e Apelit, rezulton se kërkuesi e ka parashtruar ato në formë dhe përmbajtje në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, për rrjedhojë ai nuk ka mjete të tjera në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual. Për sa i përket pretendimeve për cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor në lidhje me gjykimin dhe vendimin e Gjykatës së Lartë, kërkuesi nuk ka mjete të tjera juridike në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se për këto pretendime kërkuesi ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

15. Për sa i përket legjitimitetit *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, vendimi gjyqësor më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, mban datën 18.01.2024, ndërsa

kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë, nëpërmjet shërbimit postar, në datën 20.05.2024. Duke mbajtur parasysh se data 18.05.2024 ka qenë ditë pushimi (e shtunë) dhe se ankimi kushtetues individual nga kërkuesi është paraqitur në ditën pasardhëse të punës, Kolegji vlerëson se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

16. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t'u dëgjuar në lidhje me procesin gjyqësor në Gjykatën e Lartë dhe standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor në lidhje me vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit dhe të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Po kështu, ai ka pretenduar edhe cenimin e së drejtës së pronës. Këto pretendime janë me natyrë kushtetuese, ndaj hyjnë në kompetencën e Gjykatës, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "P", të Kushtetutës.

17. Në lidhje me pretendimin për cenimin e *së drejtës për t'u dëgjuar*, kërkuesi ka parashtruar se gjykimi i çështjes në Gjykatën e Lartë është zhvilluar në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve, ku në përfundim është përgjysmuar vlera e shpërblimit të fituar në gjykimin në shkallë të parë. Kolegji vëren se ky pretendim i kërkuesit lidhet me formën e gjykimit të çështjes së tij nga Gjykata e Lartë. Kjo e fundit, në dhomën e këshillimit, ka kryer shqyrtimin paraprak të rekursit të kërkuesit, duke arritur në përfundimin se ai nuk plotësonte kriteret e pranueshmërisë për shqyrtim në seancë gjyqësore (me ose pa praninë e palëve). Sipas ligjit procedural, shqyrtimi i pranueshmërisë së rekursit bëhet në dhomën e këshillimit, pa praninë e palëve. Në këto kushte, shqyrtimi paraprak i rekursit të kërkuesit nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit është bërë sipas formës së gjykimit të përcaktuar nga ligji. Për më tepër, një formë e tillë gjykimi edhe në rastet kur rekursi ka kaluar për shqyrtim në seancë gjyqësore, nuk është vlerësuar nga Gjykata se cenon të drejtën e palëve për t'u dëgjuar, duke u shprehur se shqyrtimi i rekursit në seancë në dhomën e këshillimit, pra mbi bazë të dokumenteve dhe pa praninë fizike të palëve, nuk do të thotë se ato nuk janë dëgjuar (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr.41, datë 22.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*) dhe se, në kontekstin kushtetues të procesit të rregullt, kjo e drejtë *realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve* (*shih vendimin nr. 43, datë 27.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ky pretendim i kërkuesit nuk mund të merret në shqyrtim.

18. Për pretendimin e kërkuesit për cenimin e *së drejtës së pronës private*, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, duke mbajtur në konsideratë se argumentet për këtë pretendim lidhen me procesin gjyqësor të kundërshtuar, Kolegji vlerëson ta shqyrtojë atë në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit prona nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor

dhe se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pronës, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë.

19. Për sa më lart, Kolegji vlerëson të analizojë në vijim vetëm pretendimin e kërkuarit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor

20. Kërkuari ka pretenduar se Gjykata Administrative e Apelit dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk kanë arsytuar në vendimet e tyre se përse është rrezuar kërkimi i padisë së tij për kamatat ligjore.

21. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsytuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsytuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Po sipas Gjykatës, detyrimi për garantimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet përgjigje e detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse dhe se arsytimi i kufizuar nuk cenon standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjit të Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 28, datë 01.11.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Për vendimet e dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit, Gjykata ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i dhomës së këshillimit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Shqyrtimi i çështjes nga dhoma e këshillimit e Gjykatës së Lartë nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Në rast se kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 9, datë 26.03.2018, nr. 27, datë 27.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Nga aktet bashkëlidhur ankimit, rezulton se procesi gjyqësor është vënë në lëvizje nga kërkuesi, i cili me padinë e tij ka kërkuar detyrimin e të paditurve, MTI-së dhe Këshillit të Ministrave, për ta kompensuar financiarisht sipas vendimit nr. 1/2001 të komisionit të posaçëm të shpronësimeve, si dhe për t'i paguar kamatat ligjore për shkak të vonesës në përmbushjen e këtij detyrimi.

24. Në përfundim të shqyrtimit, gjykata administrative e shkallës së parë ka pranuar pjesërisht padinë e kërkuesit, duke detyruar palën e paditur t'i paguajë atij: (i) kompensimin për pronat e shpronësuara për ndërtimin e ujëmbledhësit të Bovillës, në vlerën 6 819 000 lekë; (ii) kamatat ligjore për vonesën në përmbushjen e këtij detyrimi, në vlerën 6 819 000 lekë. Për pjesën tjetër të kërimit të kamatave ligjore gjykata ka vendosur rrëzimin e padisë. Sipas asaj gjykate, paditësit (kërkuesit) i është shkaktuar dëm në pasurinë e tij nga (mos)veprimet e kundërligjshme dhe me faj të palës së paditur në lidhje me përmbushjen e detyrimit ligjor të shpërblimit sipas ligjit nr. 8561/1999, prandaj ai gëzonte të drejtën e zhdëmtimit, ndërsa vlera e dëmit është në masën e vlerës së kompensimit të përcaktuar nga komisioni i posaçëm i shpronësimeve pranë ish-Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit. Për sa u përket kamatave ligjore, ajo gjykatë ka pranuar se kërkuesit i janë marrë pasuritë në vitin 2001 dhe pavarësisht kërkesave të tij të vazhdueshme ai nuk është kompensuar, ku për shkak të vonesës në pagimin e kompensimit atij i ka lindur e drejta e shpërblimit sipas nenit 450 të KC-së, referuar të cilit kërkimi për kamatat ligjore duhej të pranohej deri në vlerën e detyrimit kryesor.

25. Mbi ankimin e kërkuesit dhe të palës kundërshtare të tij, Gjykata Administrative e Apelit ka ndryshuar vendimin e gjykatës administrative të shkallës së parë, duke vendosur njëlloj si ajo në lidhje me detyrimin e palës së paditur për t'i paguar paditësit (kërkuesit) kompensim për pronat e shpronësuara në vlerën 6 819 000 lekë, ndërsa ka rrëzuar kërkimin e padisë për kamatat ligjore. Sipas gjykatës së apelit, detyrimi për pagimin e vlerës së shpronësimit rrjedh nga ligji nr. 8561/1999, i cili, për rastet e shpronësimit, përcakton vlerën e kompensimit të pronës, ndaj paditësi (kërkuesi) gëzon vetëm të drejtën e kompensimit në vlerë për pasurinë e shpronësuar, por jo të drejtën për kamatat ligjore.

26. Për rekursin e kërkuesit dhe të palës kundërshtare të tij, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tyre, me arsyetimin se shkaqet në rekurs nuk janë nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, sipas përmbajtjes së tij në kohën e paraqitjes së rekursit, të cilat ta bënin të cenueshëm vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit. Sipas atij kolegji, shkaqet e parashtruara në rekurset e palëve janë të njëjta me pretendimet/prapësimet e tyre në gjykimin e çështjes në shkallë të parë dhe në apel, të cilave u është dhënë përgjigje përfundimtare nga gjykata e apelit, ndërkohë që rekursuesit nuk kanë

parashtruar asnjë argument shtesë (përtej pretendimeve/prapësimeve të ngritura në gjykim) së përsëri analiza ligjore e rrethanave të faktit dhe zbatimi i ligjit nga gjykata e apelit ishte e gabuar.

27. Në analizë të vendimeve gjyqësore të lartpërmendura, Kolegji konstaton se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit tregon mjaftueshëm rrethanat e çështjes, kërkimet në padi, pretendimet e parashtruara nga palët, përfshirë edhe në ankimet e tyre, faktet e pranuar dhe përfundimet e nxjerra nga ato, si dhe dispozitat ligjore në të cilat ajo është bazuar për zgjidhjen e çështjes në atë mënyrë, duke argumentuar edhe pretendimet e kërkuesit në lidhje me kamatat ligjore, por, ndryshe nga ai, ka vlerësuar se ato nuk gjenin mbështetje në ligj. Në këtë mënyrë, vendimi i saj respekton kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor. Ky vendim i është nënshtruar kontrollit nga Gjykata e Lartë, e cila ka evidentuar rrethanat e rastit dhe ecurinë e procesit gjyqësor në gjykatat më të ulëta, përfshirë edhe vendimmarrjet dhe argumentet e tyre, sikundër po ashtu ka evidentuar edhe shkaqet e parashtruara në rekursin e kërkuesit, ku përmes parashtrimit të tyre tregon se, pasi i ka vlerësuar ato, ka arritur në përfundimin se rekursi i paraqitur nga kërkuesi është haptazi i pabazuar, ndërsa shkaqet e ngritura në të nuk janë nga ato të parashikuara nga ligji ose nuk gjejnë mbështetje në materialet e çështjes. Ndonëse me arsytim të kufizuar, ky vendim nuk rezulton të ketë kundërthënie dhe pjesa arsyetuese e tij lidhet me përfundimin e arritur në dispozitiv. Për sa i përket këtij arsytimi, Gjykata në mënyrë të vazhdueshme ka theksuar se ai nuk cenon standardet e arsytimit të vendimit gjyqësor dhe kjo formë arsytimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit.

28. Për sa më lart, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsytimit gjyqësor në lidhje me vendimet e gjykatave të zakonshme, është haptazi i pabazuar.

29. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.